



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 21.11.2012
Nr. 0204-1203

PËR: Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

Të pranuar më datën: 08/11/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit. Nr. 197-3 07/1934 197-3 07/1999 07/1901 07/2112 197-3, të miratuar me datë 31.10.2012 nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi për ndryshimin dhe harmonizimin e bazës ligjore të rregullores komunale Nr. 197-3;
- Vendimi për dhënien e pëlqimit në kërkesën Nr. 07/1934 të Hajri Xhelilit, Firma NPSH "Shpejtimi"- Shtime;
- Vendimi për mosaprovimin e propozimit të DSHP-së për ndryshimin e rregullores, Nr. 197-3;
- Vendimi për refuzimin e kërkesës, Nr. 07/1999 të Vedat Rashiti nga fshati Petrovë;
- Vendimi për refuzimin e kërkesës, Nr. 07/1901 të Rizah Reshanit nga fshati Petrovë;
- Vendimi për refuzimin e kërkesës Nr. 07/2112 të Gani Beça nga fshati Petrovë;
- Vendimi për aprovimin e raportit financiar Janar - Shtator 2012 ;


- Vendimi për dhënien pëlqimit në kërkesën, Nr. 07/2012 për Naim Arifi Firma "Guri Company" nga fshati Belinc ;

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Dana, 21.11.2012

Nr. 0204-1203

Za : Naim Ismaili, Gradonačelnik Opštine Stimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine Opštine Štimlje,

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKA SKUPŠTINE OPŠTINE ŠTIMLJE

Primljeno dana: 08/11/2012

Poštovani ,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Takonu za lokalnu samoupravu përcaktuar me Ligjin br. 03/L-140, Zakonu br. 03/L-049 o Finansijama Lokalne samouprave, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke. br. 197-3 07/1934 197-3 07/1999 07/1901 07/2112 197-3, usvojene dana 31.10.2012 od Skupštine Opštine Stimlje, POTVRDJUJE zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samopupravu .

Pravni Akt koji proizvodi puni pravni efekat:

- Odluka o izmeni i uskladjivanju zakonske osnove opštinske uredbe br. 197-3;
- Odluka o davanju saglasnosti na zahtev br. 07/1934 od Hajri Xhelilit, Firma NPSH "Shpejtimi"- Stimlje;
- Odluka o neusvajanju predloga SJU za izmenu uredbe , br. 197-3;
- Odluka o odbijanju zahteva, br. 07/1999 od Vedat Rashiti iz s. Petrovo;
- Odluka o odbijanju zahteva, br. 07/1901 od Rizah Reshanit iz s. Petrovo;
- Odluka o odbijanju zahteva br. 07/2112 od Gani Beça iz s. Petrovo;
- Odluka o usvajanju finansijakog izveštaja Januar - Sепetmebar 2012 ;

- Odluka o davanju saglasnosti na zahtev, br. 07/2012 za Naim Arifi Firma "Guri Company" iz sela Belinc ;

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,



Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a*
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/240, Datë: 31.10.2012

Duke u Bazuar në nenin 12 dhe nenin 40 pragrafi 2 pika (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutin e Komunës së Shtimes, nenin 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme Nr.2004/18, Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e mbajtur më datën: 31.10.2012 mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE HARMONIZIMIN E BAZËS LIGJORE TË
RREGULLORES KOMUNALE 01Nr.197-3

I

Kuvendi Komunal- Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, me shumicën e votave aprovoi vendimin për ndryshimin dhe harmonizimin e bazës Ligjore të Rregullores Komunale, 01Nr.197-3, datë: 30.9.2003, për caktimin e Orarit të punës në lëmin e Tregtisë, Hotelerisë, Zejtarisë, dhe shërbimeve tjera në Komunën e Shtimes.

II



Ndryshimet dhe harmonizimi i Rregullores Komunale, 01Nr.197-3, datë: 30.9.2003, për caktimin e Orarit të punës në lëmin e Tregtisë, Hotelerisë, Zejtarisë, dhe shërbimeve tjera në Komunën e Shtimes, ose propozimin për një rregullore të re në këtë fushë do ta prezentojë para Kuvendit, ekzekutivi deri në mbledhjen e fundit të Kuvendit për vitin 2012.

III

Deri në aprovimin e rregullores së re, mbetet në fuqi Rregullorja Komunale 01Nr.197-3, datë: 30.9.2003, për caktimin e Orarit të punës në lëmin e Tregtisë, Hotelerisë, Zejtarisë, dhe shërbimeve tjera në Komunën e Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Shërbime Publike, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili

KRYESE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data			
Datum 28.11.2012			
Date			
Njësia organizuese	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	007-1203	7	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/243, Datë: 31.10.2012

Kuvendi Komunal – Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.07/1934, datë: 24.9.2012, të z.Hajri Xhelili, (firma NPSH "Shpejtimi" sh.p.k) Rr."12 Qershori" – Shtime, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, dhënien e Pëlqimit për zhvendosjen e pajisjeve të Gurthyesit për përpunimin e Gurit, nga ngastra kadastrale Nr.413, ku gjendet tani e të vendoset, aty afër në ngastrën kadastrale 409 e cila është e evidentuar në emrin tim Hajri (Habib) Xhelili. Pëlqimin për zhvendosje të makinerisë e paraqes mbi bazën e kërkesës të Komisionit të pa varur për miniera dhe minerale, dhe në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr.03/1-163 për tu larguar me seperacion, nga shtrati i lumit.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, si dhe rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNJEN E PËLQIMIT NË KËRKESËN, 01Nr.07/1934
TË HAJRI XHELILIT, FIRMA NPSH"SHPEJTIMI" - SHTIME

I


Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 31.10.2012, unanimisht ka vendosur që të aprovoi kërkesën me numër: 01Nr.07/1934, të z.Hajri Xhelilit nga Shtimja, sipas rekomandimit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, për ti dhënë Pëlqim për zhvendosjen e makinerisë të Gurthyesit, nga ngastra kadastrale Nr.413, dhe t'i vendos në sipërfaqe prej gjithësejt 00.15.48ha. në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.409, me sipërfaqe prej 00.07.24ha dhe në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.410 me sipërfaqe prej 00.08.24ha. Zona Kadastrale-Belinc, që të tri ngastrat të evidentuara në emër të, Hajri (Habib) Xhelili nga Shtimja, Pëlqimi është në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr.03/1-163 për tu larguar me seperacion, nga shtrati i lumit.

II

Pëlqimi palës i lëshohet për rregullimin e dokumentacionit për leje të punës, që duhet ta sigurojë nga Ministria për Planifikim Hapësinor, përkatësisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pala është e obliguar që brenda 6 (gjashtë) muajve të fillojë aktivitetet për përpunimin e gurit, në këtë lokacion në të kundërtën ky vendim anulohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/239, Datë: 31.10.2012

Duke u Bazuar në nenin 12, nenin 40, pragrafi 2 pika (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; nenit 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme Nr.2004/18; Statutin e Komunës së Shtimes, si dhe duke pas për bazë propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike, për ndryshimin e Rregullores 01Nr.197-3, të datës: 30.9.2003, Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e mbajtur më datën: 31.10.2012 mori këtë:

V E N D I M

Për mosaprovimin e propozimit të DSHP-së për ndryshimin e Rregullores, 01Nr.197-3

I

Kuvendi Komunal - Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, me shumicën e votave nuk e aprovoi propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për ta ndryshuar nenin 13 të Rregullores Komunale me numër: 01Nr.197-3, të datës: 30.9.2003 për caktimin e Orarit të punës në lëmin e Tregtisë, Hotelerisë, Zejtarisë, dhe shërbimeve tjera në Komunën e Shtimes.

II


Rregullorja Komunale 01Nr.197-3, datë: 30.9.2003, për caktimin e Orarit të punës në lëmin e Tregtisë, Hotelerisë, Zejtarisë, dhe shërbimeve tjera në Komunën e Shtimes, mbetet në fuqi deri në ndryshimin ose aprovimin e rregullores së re.

III

Vendimi është marrë sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Shërbime Publike, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/244, Datë: 31.10.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.07/1999, datë: 3.10.2012, të z.Vedat Rashiti nga fshati Petrovë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, që ti lejojë vendosjen e një Kioske për shitjen e gjërave ushqimore, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.903-0, Z.K.-Petrovë. E cila evidentohet pasuri e Kuvendit Komunal të Shtimes. Shpresoj që kërkesa do të aprovohet pasi jam i pa punë.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, si dhe rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, 01Nr.07/1999
TË VEDAT RASHITI NGA FSHATI PETROVË

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, unanimitisht ka vendosur që kërkesa me numër: 01Nr.07/1999, datë: 3.10.2012, e z.Vedat Rashiti nga fshati Petrovë, si e tillë të refuzohet, me arsyetimin se kjo është qështje e ekzekutivit për të vendosur meqenëse, fjala është për një objekt (kioskë) që mund të jetë e lëvizshme.

II


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/242, Datë: 31.10.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.07/1901, datë: 18.9.2012, të z.Rizah Reshani – Petrovë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal, që ti ndihmohet me mjete financiare (shuma e pa përcaktuar) në përfundimin e ndërtimit të shtëpisë për banim, jam arsimtar i SHMU – “Bajram Curri” në Petrovë që shtatë vite, vitin e kaluar jam shpallë ndër punëtorët më të mirë. Poashtu jam edhe veteran i UÇK-së në ZO të Nerodimes, prandaj ndihma juaj është emergjente për mua si prind i tre fëmijëve student-shkollarë.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, si dhe rekomandimet e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR REFUZIMIN E KËRKESËS. 01Nr.07/1901
TË RIZAH RESHANIT NGA FSHATI PETROVË

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, unanimisht ka vendosur që të refuzojë kërkesën me numër: 01Nr.07/1901, të datës: 18.9.2012. të z.Rizah Reshanit - Petrovë, sipas rekomandimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e cila ka në program të përkrahjes vetëm familjet në asistencë sociale edhe atë sipas renditjes së përcaktuar në bazën e kërkesave.

II


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/245, Datë: 31.10.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.07/2112, datë: 22.10.2012, të z.Gani Beqa nga fshati Petrovë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, dhënien në shfrytëzim, 16 ari sipërfaqe për parkimin e autobusëve të firmës "Goni Com" në ngastrën kadastrale Nr.118/1, Z.K. – Petrovë, evidentuar Pasuri Shoqërore e Pyjeve. Periudha kohore për të cilën bëj kërkesë është 10 vjet. Investimet që do të bëhen në këtë parcelë janë: Rrafshimi i terenit (sepse aktualisht është kodër) si dhe shtruarja e një shtrese me zhavor.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, si dhe rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR REFUZIMIN E KËRKESËS. 01Nr.07/2112
TË GANI BEQA NGA FSHATI PETROVË

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, unanimisht ka vendosur që të refuzoi kërkesën me numër: 01Nr.07/2112, të z.Gani Beqa nga fshati Petrovë, me arsyetimin se: 1. Për të njëjtën hapësirë ka pasur kërkesa për shfrytëzim edhe nga banorët që jetojnë në afërsi, dhe janë refuzuar. 2. Ekzistojnë dyshime të bazuara se kërkesat bëhen me tendenca uzurpimi. 3. Arsyetimi tjetër është se me këtë mundemi me fut konflikt mes banorëve.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/241, Datë: 31.10.2012

Bazuar në nenin 40.2.d si dhe neni 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezimit të Raportit financiar nëntëmujor të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e mbajtur më: 31.10.2012, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINANCIAR JANAR-SHTATOR 2012

I


Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 31.10.2012, me shumicën e votave aprovoi Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për periudhën nëntë mujore Janar-Shatator, për vitin 2012.

II

Raporti nëntë mujor Financiar për vitin 2012, është aprovuar sipas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/2115, Datë: 22.10.2012



Npi – 01/246, Datë: 31.10.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër: 01Nr.06/2156 më 30.10.2012 të z.Naim Arifit nga fshati Belinc, (Përfaqësues i kompanis "GURI COMPANY"), i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, Pëlqim për vendosjen e mekanizmit punues (Gurthyesh) në pronën private të pronarit Jupë /Mustafë/ Arifit nga fshati Belinc, në sipërfaqe prej 00.63.56ha. në ngastrën me numër P-72809006-00654-0, vendi i quajtur "Prroni" Zona Kadastrale-Belinc me të cilin kemi kontratë të vërtetuar për shfrytëzim për afatin prej 5 vite. Parcela më nevojitet për zgjerimin e sipërfaqes, për shkak se Inspektorët e APMM-së kanë kërkuar që rëra të largohet në distancën e caktuar.

Kuvendi Komunal pasi analizoi, kërkesën e palës mori këtë:

V E N D I M

**PËR DHËNJEN E PËLQIMIT NË KËRKESËN, 01Nr.07/2012
PËR NAIM ARIFI FIRMA "GURI COMPANY" NGA FSHATI BELINC**

I

Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 31.10.2012, unanimisht aprovoi kërkesën, 01Nr.07/2012 të z.Naim Arifit nga fshati Belinc, përfaqësues i kompanisë ("GURI COMPANY-1") dhe i jep pëlqim për vendosjen e mekanizmit punues (Gurthyesh) në pronën private të pronarit Jupë /Mustafë/ Arifit nga fshati Belinc, në sipërfaqe prej: 00.63.56ha. në ngastrën me numër P-72809006-00654-0, vendi i quajtur "Prroni" Zona Kadastrale-Belinc.

II

Pëlqimi palës i lëshohet për rregullimin e dokumentacionit për leje të punës, që duhet ta sigurojë nga Ministria për Planifikim Hapsinor, përkatësisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, për përpunimin e Gurit natyror. Pala është e obliguar që brenda 6 (gjashtë) muajve të fillojë aktivitetet për përpunimin e gurit, në të kundërtën ky vendim anulohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili